



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA DYPALËSHE E TRANSPORTIT AJROR MIDIS KOSOVËS DHE ZVICRËS



BUJLETIN

1 dhjetor 2010 Nr.2

CAA
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

ANP-ja PAGËZOHET ME EMRIN E KOMANDANTIT LEGJENDAR “ADEM JASHARI”

Me vendim të Qeverisë së Kosovës të datës 5 nëntor 2010, emri zyrtar i aeroportit do të jetë Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”. Ceremonia kryesore e emërimit të aeroportit, gjatë së cilës edhe u zbulua mbishkrimi i ri nga zyrtarët më të lartë të vendit, u mbajt më 28 nëntor 2010, ditë kjo që shënon, veç tjerash, edhe ditëlindjen e Komandantit Legjendar Adem Jashari. Emri i ri i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës na bën të gjithëve krenarë. Në bazë të aplikacionit të pranuar nga aeroporti, AAC-ja ka lëshuar certifikatën e re e cila reflekton emrin e ri Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”.



28 nëntor 2010: Nga ceremonia e pagëzimit të aeroportit me emrin 'Adem Jashari'

SAMITI BALLKANIK I AVIACIONIT



Antalia, 28 tetor 2010: Nënshkrimi i Deklaratës së Antalisë

Prej 27-28 tetor 2010, në Antalia të Turqisë, u mbajt Samiti Ballkanik i Aviacionit. Ky Samit me titull karakteristik “Nga e kaluara e përbashkët, drejt një partneriteti strategjik”, u organizua nën patronatin e Drejtorit të Përgjithshëm të Aviacionit Civil të Turqisë, z. Ali Ariduru. Në Samit morën pjesë AAC-të e vendeve të Ballkanit Perëndimor si dhe ajo e Moldavisë. AAC-ja e Kosovës u përfaqësua nga Dritan Gjonbalaj, Drejtor i Përgjithshëm, Besnike Ukmata, Drejtoreshë e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Rregullimit Ekonomik si dhe Eset Berisha, Zyrtar Ligjor i Aviacionit. Gjatë punimeve, shteti nikoqir si dhe shtetet pjesëmarrëse patën mundësi të prezantojnë të arriturat e tyre në fushën

e aviacionit civil. Z. Ariduru prezantoi sistemin e aviacionit civil të Turqisë, i cili është tepër i zhvilluar duke marrë parasysh numrin e aeroporteve, udhëtarëve si dhe industrinë e transportit ajror atje. Sa për ilustrim, 85 milionë udhëtarë janë shërbyer gjatë vitit 2009 nëpër 40 aeroportet e Turqisë. Në kontekstin evropian, Turqia luan rol të rëndësishëm në transportin ajror kur dihet se Aeroporti Ataturk i Stambollit ka qenë i nënti në listën e aeroporteve evropiane me më së shumti udhëtarë në vitin 2009. Numri i udhëtarëve ndërmjet BE-së dhe Turqisë ka qenë më shumë se 25 milion në vitin 2008 dhe në këtë mënyrë Turqia, pas Amerikës dhe Zvicrës, është tregu i jashtëm më i madh për BE-në si për-

ket transportit ajror. Z. Gjonbalaj mbajti prezantimin me titull “Aviacioni Civil në Kosovë- prej ‘zeros’ deri te zbatimi i Marrëveshjes ECAA”, përmes të cilit pjesëmarrësit u njoftuan me zhvillimet në aviacionin civil të Kosovës që nga paslufta. Në ditën e dytë të punimeve të Samitit, më 28 tetor 2010, u nënshkrua Deklarata e Antalisë mbi zhvillimin e bashkëpunimit midis shteteve të Ballkanit në fushën e aviacionit civil. Përmes kësaj Deklarate, Drejtorët e Përgjithshëm të shteteve pjesëmarrëse u zotuan për themelimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm në fushat e sigurisë, sigurimit, mbikëqyrjes dhe inspektimit, shkëmbimit të ekspertëve dhe legjislacionit nacional, certifikimit dhe licencimit si dhe fushave të tjera. Shtetet pjesëmarrëse u pajtuan në parim që të nënshkruajnë një Memorandum Mirëkuptimi përmes të cilit do të konfirmohej pajtueshmëria për themelimin e një mekanizmi të bashkëpunimit në fushën e aviacionit civil të quajtur Grupi Ballkanik i Aviacionit. Për t’i arritur objektivat e kërkuara, ky Grup do të drejtohej nga një Komitet Ekzekutiv si dhe një numër grupesh punuese. Është planifikuar që ky memorandum të nënshkruhet para përfundimit të vitit 2010.

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA DYPALËSHE E TRANSPORTIT AJROR MIDIS KOSOVËS DHE ZVICRËS



Prishtinë, 30 nëntor: Nga ceremonia e nënshkrimit të Marrëveshjes Kosovë-Zvicër

Më 30 nëntor 2010, në Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit u nënshkrua Marrëveshja dypalëshe midis Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane në lidhje me shërbimet e rregullta ajrore. Marrëveshjen e nënshkroi z. Fatmir Limaj, Ministër i Transportit dhe Postë-Telekomunikacion-

it, dhe z. Lukas Beglinger, Ambasador i Zvicrës në Republikën e Kosovës. Sipas të drejtës ndërkombëtare, transporti i rregullt ajror midis shteteve zhvillohet në bazë të marrëveshjeve bilaterale, apo multilaterale. Marrëveshja me Zvicrën është negociuar me sukses gjatë vitit 2009 nga autoritetet aeronautike të të

dy vendeve. Kjo marrëveshje është në përputhje me frymën liberale të tregut të hapur dhe mundëson liri të pakufizuara trafiku për kompanitë e rregullta ajrore të të dy vendeve. Udhëtarët do të kenë mundësi më të mëdha fluturimi midis Kosovës dhe Zvicrës me çmime më të lira dhe pa ngritje të paarsyeshme të çmimeve gjatë sezonit veror.

Për disa vite me radhë, udhëtarët nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës më së shumti kanë fluturuar për në dhe nga Zvicra. Shprehur në përqindje, afro 30% e numrit total të udhëtarëve shkojnë ose vijnë nga Zvicra duke e bërë kështu Zvicrën destinacion numër një nga Kosova. Kjo është e kuptueshme kur merret parasysh numri i madh i bashkëkombasve tanë që jetojnë e punojnë në Zvicër.

Marrëveshja dypalëshe me Zvicrën është e para në fushën e transportit ajror që ka nënshkruar Republika e Kosovës. Transporti ajror midis Kosovës dhe shteteve të BE-së është i rregulluar përmes Marrëveshjes multilaterale mbi Hapësirën e Përbashkët Ajrore Evropiane.

EDITORIAL



Dritan Gjonbalaj
Drejtor i përgjithshëm i aviacionit civil

Kur vendosëm ta përgatisnim një buletin mujor për aktivitetet e AAC-së, e menduam vetëm për nevojat e brendshme të agjencisë sonë. Në radhë të parë, e menduam të shërbente si informator për Bordin tonë mbikëqyrës. Shpesh jemi aq të zënë me punët tona,

saqë nuk e kemi fort idenë se çfarë po bëjnë kolegët tjerë. Prandaj, buletini do të ishte një doracak i vlefshëm edhe për tërë personelin e AAC-së, për të qenë më të informuar rreth punës së njëri-tjetrit.

Numri i parë eksperimental i buletinit na u duk aq i mirë, saqë vendosëm t'i përkushtojmë më shumë kohë dhe përpjekje përgatitjes së numrave të tjerë, në mënyrë që t'i ndajmë me tërë komunitetin e aviacionit civil dhe më gjerë. Ky numër, përveç tjerash, sjell disa momente nga emërtimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës me emrin e Komandantit Legjendar Adem Jashari; raportin mbi nënshkrimin e Marrëveshjes së parë bilaterale të transportit ajror të Republikës së Kosovës; ju çon në Antalia ku AAC-ja

mori pjesë në Samitin Ballkanik të Aviacionit; pasqyron bashkëpunimin e mirë rajonal të AAC-së; ju merr me vete në inspektimet e aeroplanëve të huaj në aeroport, ku për shkak të përmirësimeve në infrastrukturë, tash mund të aterroni edhe në dukshmëri shumë më të vogël, dhe; ju sjell pak aromë Holande, nga njëri prej kolegëve tanë që është duke mbaruar studimet master në të drejtën e aviacionit, si bursist i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian.

Sipas raportit të progresit për vitin 2010, përgatitur nga Komisioni Evropian, Kosova ka arritur progres të theksuar në aviacionin civil dhe se zhvillimet në këtë sektor kanë qenë pozitive. Kjo është arritur me punën

e palodhshme të personelit të AAC-së, MTPT-së, MPB-së, KHAIA-s, dhe natyrisht, Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Ky sukses i yni u dedikohet edhe gjithë atyre kompanive të huaja ajrore që fluturojnë në Kosovë dhe partnerëve të tyre vendorë. Urime!

Misioni ynë është siguria e aviacionit civil në Republikën e Kosovës. Për ta mbajtur këtë nivel sigurie, ne bashkëpunojmë ngushtë me rregullatorët e vendeve tjera dhe kolegët nga industria e aviacionit. Prandaj, flini të qetë edhe 10 mijë metra mbi tokë në mot me turbulencë, sepse janë ekipe të tëra profesionistësh të përkushtuar që të kujdesen për sigurinë tuaj. Lidheni rripin e sigurisë – po fluturojmë.

RAPORTI I PROGRESIT I KE-së REFLEKTON PUNËN E MADHE NË SEKTORIN E AVIACIONIT CIVIL

Më 9 nëntor 2010, Komisioni Evropian publikoi Raportin e Progresit të Kosovës 2010. Ky raport përfshin zhvillimet e Kosovës në të gjitha sferat në periudhën prej mesit të shtatorit 2009, deri në fillim të tetorit 2010. Progresi është matur në bazë të vendimeve të marra, legjislacionit të miratuar dhe masave të zbatuara në Kosovë. Raporti është hartuar nga KE-ja në bazë të informatave të mbledhura nga autoritetet kosovare, shtetet anëtare të BE-së, organizmat ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë etj. Në këtë kontekst, departamenti i marrëdhënieve ndërkombëtare brenda AAC-së raporton në baza tremujore mbi përparimin e Kosovës në zbatimin e Marrëveshjes ECAA.

Në nënkapitullin e politikave sektoriale, më saktësisht – të transportit, është raportuar edhe për transportin ajror. Në vazhdim, janë shkëputur disa fjalë nga kjo pjesë:

“Ka pasur progres të konsiderueshëm në transportin ajror. Legjislacioni substancial, sipas Marrëveshjes Evropiane për një Zonë të Përbashkët të Aviacionit (ECAA), tashmë është integruar në legjislacionin e vendit dhe implementimi i plotë i fazës së parë kalmtare të Marrëveshjes mund të jetë i mundshëm deri në fillim të vitit 2011, me kusht që përpjekjet të vazhdojnë në të gjitha fushat, përfshirë ndihmën shtetërore dhe orarin e punës.”

Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së, gjatë mbledhjes me tërë personelin më 19 nëntor 2010, shprehu kënaqësinë e tij për një vlerësim kaq pozitiv dhe real të progresit në raport dhe përgëzoi e falënderoi personelin për punën e dedikuar në përmbushjen e detyrave për të zbatuar plotësisht Marrëveshjen ECAA.

VIZITA E DELEGACIONIT TË AGJENCISË KROATE TË AVIACIONIT CIVIL NË KOSOVË



AAC, 22 tetor 2010: Nga mbledhja e autoriteteve aeronautike kosovare me delegacionin kroat

Me ftesë të Bordit Mbikëqyrës të AAC-së, gjatë 21 dhe 22 tetorit qëndruan në Kosovë një delegacion i Agjencisë së Aviacionit Civil të Kroacisë.

Delegacioni kroat përbëhej nga Roman Gebauer, Kryetar i Bordit; Stanislav Pavlin, Zëvendës Kryetar Bordi dhe Josip Čuletić, Anëtar Bordi; Omer Pita, Drejtor i Agjencisë Kroate të Aviacionit Civil dhe Marin Puh, Zëvendës Drejtor. Në një takim të përbashkët midis delegacionit kroat dhe të gjitha autoriteteve aeronautike të Kosovës, më 22

tetor, kolegët kroatë u njoftuan më për së afërmi me sistemin rregullator të aviacionit në Republikën e Kosovës, ndarjen e përgjegjësisë mes autoriteteve të ndryshme, përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së etj.

Gjatë këtyre dy ditëve u shkëmbyen praktikat relevante që kanë të bëjnë me ushtrimin e përgjegjësisë të Bordit, sfidat e dy shteteve në zbatimin e legjislacionit evropian në fushën e aviacionit, anëtarësimin në ICAO, vështirësinë e mbajtjes së personelit deficituar nëpër

autoritetet rregullative etj. Përndryshe, kjo vizitë erdhi si rrjedhojë e vizitës të cilën Bordi Mbikëqyrës i AAC-së ia bëri Agjencisë Kroate të Aviacionit Civil në maj të këtij viti. Z. Pita dhe Z. Gjonbalaç u pajtuan që të nënshkruajnë një Memorandum Mirëkuptimi midis dy Agjencive në dhjetor të këtij viti.

Ky memorandum do të shërbejë si kornizë ligjore për bashkëpunimin dhe asistencën e ndërsjellë në implementimin e standardeve më të larta të aviacionit civil.

PO SHQYRTOHEN MUNDËSITË E RIHAPJES SË HAPËSIRËS SË LARTË AJRORE TË KOSOVËS

Më 23 nëntor 2010, në ambientet e AACK-së u mbajt një takim midis përfaqësuesve të NATO-s nga Brukseli dhe atyre të AACK-së dhe Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror në lidhje me mundësinë e hapjes së hapësirës së lartë ajrore të Republikës së Kosovës.

Siç dihet, që nga përfundimi i luftës në vitin 1999, hapësira e lartë ajrore e Kosovës është e mbyllur për mbifluturime nga NATO-ja. Autoritetet tona, që nga shpallja e pavarësisë, janë duke punuar ngushtë me NA-

TO-n në hapjen e hapësirës së lartë ajrore të vendit tonë. Për këtë qëllim, NATO-ja, përmes një paneli teknik përgjegjës për normalizimin e aviacionit në Ballkan, ku merr pjesë edhe AAC-ja, po mundohet të gjejë zgjidhje të përshtatshme për rihapjen e hapësirës së lartë ajrore të Kosovës.

Në këtë kontekst, përfaqësuesit e NATO-s, përgjegjës për hapësirën ajrore mbi Evropë, kanë filluar një turne të bisedave bilaterale me shtetet e rajonit për të identifikuar një ofrues të

shërbimeve të navigacionit ajror, që do të ishte në gjendje që përkohësisht ti ofronte këto shërbime në hapësirën e lartë ajrore të Kosovës. Ofruesi i identifikuar do t'i jepte këto shërbime nën delegimin e NATO-s dhe me miratim të Republikës së Kosovës, në mënyrë që të përmbushen objektivat e Qiellit të Vetëm Evropian.

Rihapja e hapësirës ajrore të Kosovës do të sillte zvogëlime shpenzimesh për kompanitë ajrore si dhe përfitim ekonomik për vendin.



Kosova nga ajri. Foto: Naser Grajçevci

RREGULLOHET ÇËSHTJA E NDËRTIMEVE PËRRETH AEROPORTIT

Më 20 tetor 2010, ka hyrë në fuqi Rregullorja me titull “Zonat Mbrojtëse të Aeroportit”. Kjo rregullore, e sponsoruar nga departamenti i Aerodromeve në AAC, ka për qëllim mbrojtjen e një sipërfaqeje të caktuar përreth aeroportit nga ndërtimet të cilat do të mund të paraqisnin pengesa në operimet e aeroplanëve në aeroport. Rregullorja është e aplikueshme për institucionet përgjegjëse për lëshimin e lejeve të ndërtimit. Kjo rregullore kërkon që komunat apo ministritë përkatëse, para se të lëshojnë leje për ndërtim në afërsi të aeroporteve, të kërkojnë edhe vlerësimin nga operatori i aerodromit dhe nga AAC-ja për pengimin e mundshëm të këtyre objekteve në operime të Aeroportit.

AAC-ja PO VAZHDON ME KOMPLETIMIN E LEGJISLACIONIT TË FAZËS SË DYTË TË ECAA-së

Gjatë muajve tetor dhe nëntor është kurorëzuar puna disa mujore në transponimin e disa akteve nënligjore që janë kërkesë e fazës së dytë të zbatimit të Marrëveshjes ECAA. Në vazhdim janë listuar rregulloret që kanë hyrë në fuqi:

- **Rregullorja 6/2010** mbi kërkesat për sistemet automatike që nevojiten në shkëmbimin e të dhënave për fluturimin me qëllim të njoftimit, koordinimit dhe transferimit të trafikut në mes të njësive të Kontrollit të Trafikut Ajror. Kjo rregullore përcakton kushtet e sigurisë dhe të kualitetit për sistemet automatike që nevojiten në shkëmbimin e të dhënave për fluturimet.
- **Rregullorja 7/2010** mbi kërkesat për hapësirën e kanaleve të komunikimit tokë-ajër. Rregullorja përcakton kushtet për hyrjen e koordinuar në shfrytëzim të komunikimit tokë-ajër bazuar në hapësirën e kanalit 8.33 kHz.
- **Rregullorja 8/2010** mbi rregullat implementuese për integrimin e ndodhive në aviacionin civil në bazën e të dhënave qendore në përputhje me Direktivën 2003/42 të Këshillit dhe Parlamentit Evropian
- **Rregullorja 9/2010** mbi rregullat implementuese për shpërndarjen e informatave te palët e interesuara të ndodhive në aviacionin civil sipas Nenit 7 (2) të Direktivës 2003/42 së Këshillit dhe Parlamentit Evropian

- **Rregullorja 10/2010** mbi rregullat për organizimin dhe përbërjen e Bordit të Apelit të Agjencionit Evropian të Sigurisë së Aviacionit
- **Rregullorja 11/2010** mbi metodat e punës së Agjencionit Evropian të Sigurisë së Aviacionit për kryerjen e inspektimeve të standardizimit
- **Rregullorja 12/2010** mbi kërkesat për certifikimin e Ofruesve të Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Rregullorja përcakton kushtet dhe procedurat për aplikimin dhe hapat e ndërmarrë nga AAC-ja për certifikimin e OSHNA-ve.

INSPEKTORËT E AAC-së SIGUROHEN QË AEROPLANËT JANË TË SIGURT

Në bazë të Nenit 50 të Ligjit për Aviacionin Civil dhe të Direktivës 2004/36/CE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian (Programit SAFA të Komunitetit Evropian), inspektorët e AAC-së mund të bëjnë inspektimin në platformë të aeroplanëve nga shtetet e huaja. Qëllimi i këtyre inspektimeve është që të vërtetohet se aeroplanët janë në gjendje teknike për fluturime të sigurta dhe se janë duke u operuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Gjatë kryerjes së këtyre inspektimeve, inspektorët bazohen në Publikimin teknik nr.6 (Vlerësimi i Sigurisë së Mjeteve të Huaja Ajrore (SAFA) –Manual Procedurash) të AAC-së, dhe në Materialin udhëzues (SAFA Ramp Inspections) të Agjencisë Evropiane për Sigurinë e Aviacionit. Princip shumë i rëndësishëm të cilit i përmbahen inspektorët është mosdiskriminimi midis operatorëve ajrorë, pra të gjithë mund të jenë subjekt i inspektimit dhe për të gjithë vlejnjë rregullat e njëjta.

Gjatë muajit nëntor inspektorët Bajram Xhemaili, Naser Grajçevci, Matej Krasniqi dhe Betim Bekteshi kanë kryer 9 inspektime SAFA (Safety Assessment of Foreign Aircraft) të aeroplanëve, të cilët kanë atëruar në ANP. Inspektorët kanë konstatuar një gjetje të kategorisë 2 të njëra prej kompanive dhe për këtë është njoftuar autoriteti i aviacionit civil i shtetit licencues dhe menaxhmenti i kompanisë në fjalë.



ANTA AUDITOHET BASHKËRISHT NGA INSPEKTORË TË AAC-së SË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

Agjencia Nationale e Trafikut Ajror e Shqipërisë, e njohur si ANTA, është audituar nga 1 deri më 5 nëntor 2010 nga inspektorë të navigacionit ajror të AAC-së së Shqipërisë dhe AAC-së së Kosovës. Kjo paraqet zbatimin në praktikë të një Memorandumi të Mirëkuptimit midis AAC-ve të Shqipërisë dhe Kosovës për bashkëpunim teknik të nënshkruar në fund të vitit 2009. Inspektorët kosovarë të fushës së navigacionit ajror, Arianit Islami dhe Muhamed Luta, shpjeguan se qëllimi i auditimit ishte mbikëqyrja dhe verifikimi i zbatimit të masave të ndërmarrura për defektet e identifikuara në auditimin e vitit të kaluar, si dhe aplikimin e kërkesave që dalin nga rregulloret tjera relevante të aplikueshme për ANTA-n.



PREZANTIM MBI MANUALIN PËR AUTORITETIN MBIKËQYRËS KOMBËTAR

Më 29 tetor, në sallën e konferencës “Amelia” në AAC, u mbajt një prezantim me temën “Manuali për Autoritetin Mbikëqyrës Kombëtar” nga

U MBAJT USHTRIMI GJITHËPËRFSHIRËS I EMERGJENCËS "SKIFTERI" NË AEROPORT

Sipas Aneksit 14 të ICAO-s, operatorët e aerodromeve duhet të mbajnë një ushtrim gjithëpërfshirës të emergjencës së paku një herë në dy vite. Një ushtrim i tillë është organizuar nga Aeroporti më datë 26 tetor 2010. AAC-ja ka luajtur rolin përkatës në këtë ushtrim, sipas manualit "Plani Emergjent i ANP-së", dhe ka vëzhguar të gjithë ushtrimin, për ta vlerësuar rrjedhën e procesit dhe reagimin e të gjitha agjencive në këtë ushtrim.

Në këtë ushtrim u simulua një aksident aeroplani Airbus 320 me udhëtarë, i cili pati problem gjatë ngritjes nga ANP-ja. Pas aksidentit, secila agjenci (zjarrfikësit, policia, ambulanca, Forca e Sigurisë së Kosovës etj.) reagoi sipas përgjegjësisë dhe procedurave të definuara në planin emergjent, duke përfshirë shuarjen e zjarrit, gjetjen e viktimave të mundshme, shpëtimin e të lënduarve nga rrënojat e Aeroplanit, trajtimin e të lënduarve dhe familjarëve, transportimin e të lënduarve në Qendrat për Kujdesin Mjekësor etj.

Në momentin e aktivizimit të emergjencës, u aktivizua edhe Komiteti Operativ i Emergjencave (KOE) i cili ka rol komandues dhe në të cilin përfaqësohen të gjitha agjencitë që kanë rol në menaxhimin e emergjencave. AAC-në në këtë Komitet e ka përfaqësuar Burim Dinarama, Inspektor i Aerodromeve, përderisa rrjedhën e tërë ushtrimit e kanë vëzhguar edhe 7 inspektorë nga AAC-ja, të pozicionuar në pika të ndryshme.

Sa i përket organizimit dhe menaxhimit të KOE-së, Burim Dinarama, thekson: "Në përgjithësi, si i tërë ushtrimi ashtu edhe puna në KOE, është vlerësuar si pozitive, megjithatë, ne si autoritet kemi pasur disa vërejtje, në veçanti lidhur me reagimin e disa prej agjencive të jashtme pjesëmarrëse në ushtrim si dhe me komandimin në KOE. Këto vërejtje do të reflektohen në Planin Emergjent, që në fakt është edhe arsyeja kryesore e mbajtjes së ushtrimeve gjithëpërfshirëse të këtij lloji në Aeroport."



Aeroport, 26 tetor 2010: Pamje nga ushtrimi emergjent "Skifteri"



Aeroport, 26 tetor 2010: Nga puna e Komitetit Operativ të Emergjencave

ËSHTË LEHTËSUAR ATERRIMI NË KUSHTE TË DUKSHMËRISË SË ULËT NË AEROPORT

Më 14 shtator 2010, AAC-ja ka bërë aprovimin e operimeve të kategorisë së dytë (CAT II) në Aeroport. Ky aprovim vjen pas një pune të madhe të Aeroportit dhe një mbikëqyrjeje të rreptë njëvjeçarenga AAC-ja në përbushjen dhe verifikimin e procedurave, infrastrukturës, trajnimeve, pajisjeve etj. konform standardeve të Aneksëve 3, 10, 11 dhe 14 të Konventës së Çikagos.

Operimet CAT II mundësojnë ngritjen e nivelit të sistemit instrumental të aterrimit. Me këtë sistem, aeroplanët mund të aterrojnë me dukshmëri më të vogël (jo më pak se 300m) se në kategorinë aktuale të operimeve të ANP-së, ku dukshmëria e kërkuar për aterrim, është jo më pak se 550m. Sistemi i ri ndihmon në zvogëlimin e anulimeve për shkak të kushteve të këqija atmosferike në Aeroportin e Prishtinës (mjegulla etj.).

Drejtori i Departamentit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror në AAC, Arianit Islami.

Ky prezantim kishte për qëllim informimin e personelit të AAC-së mbi përmbajtjen e këtij doracaku që mund të përdoret jo vetëm nga Autoritetet Mbikëqyrëse Kombëtare. Në këtë prezantim janë identifikuar aktivitetet që i mbulon ky doracak, e që mungojnë në AAC. Arianit Islami shpjegoi se mënyrë efektive për identifikimin e mangësive janë listat kontrolluese (checklistat) të ISO Standardeve që kanë të bëjnë me sistemin e cilësisë në një organizatë.

Prezantimi zgjoi interesim dhe një debat interesant në sallë, si dhe u diskutua mundësia që se-

cili departament ta përdorë këtë mënyrë për identifikimin e proceseve që mungojnë dhe zhvillimin e tyre bazuar në këtë Manual.

BASHKËPUNIMI MIDIS AAC-VE TË KOSOVËS DHE KROACISË NË FUSHËN E SIGURISË AJRORE

Në fillim të nëntorit, departamenti i sigurisë së fluturimeve në AAC ka pranuar disa manuale nga kolegët e tyre të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kroacisë. Manualët e dërguara janë: Manuali i Inspektorëve të Operimeve Ajrore (OPS); Manuali i Inspektorëve të Vlefshmërisë Ajrore (AIW), Manuali i Inspektorëve të Licencimit

të Personelit (PEL) dhe Manuali i Inspektorëve për Aviacionin të Përgjithshëm (General Aviation). Këto manuale janë të gjitha të vitit 2010 dhe janë rezultat i punës rreth 20 vjeçare të AAC-së kroate.

Sipas Kushtimit Musës, drejtor në departamentin e sigurisë së fluturimeve, manualet janë të nevojshme për inspektorët e sigurisë së fluturimeve në ushtrimin e kompetencave të tyre në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atij të BE-së në fuqi në fushën e sigurisë ajrore. Ai, përmes një letre, falënderoi homologun e tij kroat për dërgimin e këtyre manualeve dhe e cilësoi këtë hap si të parin në bashkëpunimin e vazhdueshëm që do ta kenë në të ardhmen.

SEMINAR MBI NDËRTIMIN E KAPACITETEVE TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS KOMBËTAR

Një seminar treditor mbi themelimin dhe fuqizimin e Autoriteteve Mbikëqyrëse Kombëtare (AMK) u mbajt në Sekretariatit dhe Këshillit për Bashkëpunim Regjional në Sarajevë prej 23 deri më 25 nëntor 2010. AAC-ja u përfaqësua nga Arianit Islami e Zana Limani. Në seminarin e organizuar nga ISIS, morën pjesë përfaqësuesit e shteteve të rajonit, përfaqësuesit e Komisionit Evropian, Eurocontrolit, AMK-sës së Belgjikës dhe Rumanisë, si dhe ofruesit e shërbimeve të navigacionit ajror nga Zvicra dhe Danimarka. Gjatë punimeve u theksua rëndësia e një AMK-je të



fortë në zbatimin efektiv të legjislacionit të Qiellit të Vetëm Evropian dhe të sigurisë së aviacionit në përgjithësi. Theks i veçantë i është dhënë profilit dhe trajnimeve të nevojshme të personelit që punojnë në AMK, dokumentacionit, procedurave dhe politikave që duhen zhvilluar në AMK, në mënyrë që të funksionojë në mënyrë të efektshme.

Përpos diskutimit të temave të ndryshme me interes për AMK-të, gjatë seminarit, përfaqësues të shteteve të BE-së prezantuan sfidat dhe problemet e ndryshme të cilat janë ballafaquar, si dhe mënyrat e zgjidhjeve të cilat i kanë aplikuar.

Drejtori i SHNA-së, Arianit Islami, ka dhënë intervistë për një kanal televiziv lokal në lidhje me takimin si dhe rezultatet të cilat i ka arritur Kosova në përputhjen e legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së në fushën e aviacionit.

Universitetin e Lejdenit, universitetin më të vjetër në Holandë, të themeluar në vitin 1575. Instituti i të Drejtës së Aviacionit dhe Kozmosit në këtë universitet këtë shtator ka mbushur 25vjet, edhe pse një katedër e të drejtës së aviacionit në Fakultetin e Drejtësisë ka ekzistuar që nga viti 1938, thotë Arianiti. Instituti është themeluar nga Prof. Henri Wasenbergh, një figure e njohur në fushën të cilën po e studion Arianiti, ndërsa tash drejtohet nga Prof. Pablo Mendes de Leon.

Arianiti tregon që lëndët në semestrin e parë janë të ndara në tri segmente: e drejta e BE-së, e drejta private e aviacionit dhe e drejta publike e aviacionit, duke përfshirë edhe të drejtën penale të aviacionit.

Nga fusha e së drejtës publike disa prej temave që po ligjërohen janë përgjegjësia e shtetit dhe e korporatave publike në ofrimin e shërbimeve, temat ambientale në aviacion, pastaj një rëndësi e veçantë i është kushtuar marrëveshjes për liberalizimin e shërbimeve të transportit ajror SHBA-BE - Open Skies, dhe siguria dhe sigurimi në aviacion.

Nga fusha e së drejtës private, sistemi i Varshavës, ku përfshihet Konventa e Varshavës e vitit 1929 me disa protokolle, dhe Konventa e Montrealit e vitit 1999 janë shtjelluar në detaje. Leksionet këtu

janë fokusuar në përgjegjësinë për vonesa dhe lëndime në transportin e udhëtarëve, përgjegjësinë në bartjen e mallrave, konfliktin e ligjeve, si dhe kushtet e kontratës së transportit të IATA-s (biletat standarde të udhëtimit). I pyetur të veçojë anët më atraktive të programit, ai thotë se është numri i ligjëruesve mysafirë që vijnë nga shumë institucione me renome anekënd globit. Secili prej tyre jep një perspektivë të veçantë, edhe nëse tema është mbuluar më parë, thotë Arianiti. Këtu përmend z. George Tompkins, një avokat me përvojë të gjatë në mbrojtjen e kompanive ajrore në rastet e aksidenteve; Roderick van Dam, udhëheqës i shërbimeve ligjore në EUROCONTROL; Fredrik Kämpfe, Këshilltar Ligjor në EASA; Berend Crans nga firma ligjore holandeze De Brauw; Paul Mifsud, ideatori i konceptit të liberalizimit të shërbimeve të transportit ajror Open Skies; e shumë të tjerë.

Pastaj ai shpjegon për një detyrë simulim të rastit gjyqësor nga e drejta private e aviacionit të mbajtur në Gjykatën e Qarkut të Harlemit, ku Arianiti ishte bashkë-prezantues para trupit gjykues. Grupi i tij kishte argumentuar për mbisundimin e Konventës së Montrealit ndaj Rregullores 261/2004 të BE-së, një mision pothuajse i pamundur

duke marrë parasysh qëndrimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, shpjegon ai. Për semestrin e dytë, Arianiti thotë se programi do të fokusohet në të drejtën e kozmosit dhe të drejtën evropiane të konkurrencës. Në të njëjtën kohë, në mars ai do ta përfaqësoj Institutin në një garë ndërkombëtare në të drejtën publike ndërkombëtare të aviacionit, që do të mbahet në Dubai. Është një rast që nga ana tematike ngërthen një "taksë" ambientale, një shpërthim vullkanik që pasohet me mbyllje të hapësirës ajrore, kabotazh selektiv, problemin e pronësisë dhe kontrollit të kompanive ajrore nga qytetarë të shteteve të treta dhe ndërprerje të njëanshme të marrëveshjes bilaterale, ndërsa kërkon hulumtim të vazhdueshëm të të gjitha këtyre problemeve gjatë gjithë kohës deri në muajin mars. Pa marrë parasysh çfarë do të jetë rezultati, Arianiti shprehet i kënaqur për mundësinë për t'i studiuar thellësisht disa probleme shumë relevante për të cilat askush nuk ka përgjigje definitive. Arianiti pritet t'i përfundojë studimet në gjysmën e dytë të vitit 2011. Studimet e tij mundësohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Komisioni Evropian, përmes programit të bursave Young Cell.

SHPALOSJE NGA STUDIMET E ARIANIT DOBROSHIT NË UNIVERZITETIN E LEIDEN

Arianit Dobrosi, Zyrtar për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Projekte dhe Rregullim Ekonomik të Aviacionit në AAC, po ndjek studimet specializuese në



Impressum:

Redaktore: Besnike Ukmata, **Në këtë numër kontribuan:** Dritan Gjonbalaj, Lendita Kika-Berisha, Kushtrim Musa, Muhamed Luta, Naser Grajcevc, Zana Limani.